

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7956
E enjte, 19 dhjetor 2024
Çmimi 0.50

Lajçaku: Kosova
ta themebjë Asociacionin,
Serbia t'i njohë
simbolet e Kosovës | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

MUNICIONET 'MADE IN KOSOVA', NJË AMBICIE ENDE E LARGËT

| FAQE 4-5



Edip Terelina (RF ER)

Këto ditë kishte shumë bujë për marrëveshjen ndërmjet Kosovës dhe Turqisë për ndërtimin e fabrikës së parë të municionit në Kosovë. Edhe pse shumëçka

rreth saj mbahet sekret, për ministrin e Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ky do të jetë një hap shumë i rëndësishëm drejt fuqizimit të kapaciteteve

ushtarake të vendit. Fabrika e paralajmëruar e municioneve, sipas tij, do të krijojë jo vetëm aftësi vetjake të mbrojtjes, por edhe mundësi eksporti

MËRGATA E KOSOVËS DO TË MUND TË VOTOJË NË AMBASADA DHE NË KONSULLATA NË 22 SHTETE F. 3



KOSOVA BËHET ME MUZE TË GJENOCIDIT DHE PËRPJEKJES PËR LIRI F. 7



OPINION

BABADIMRI I LV-SË, DORËLIRI UBO! F. 5

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



AKTUALE



GREQIA THOTË SE MBËSHTETJA E SAJ PËR ANËTARËSIMIN E SHQIPËRISË NË BE ËSHTË E KUSHTËZUAR F. 2

HAXHI SHALA PRANON FAJËSINË PËR GJYKATËS NË HAGË F. 5

EKONOMI



LANSOHET ANKANDI I PARË PËR ENERGJI NGA ERA ME KAPACITET 100 MW F. 8

SPORT



RAMADANI: TANI TË MENDOJMË PËR SFIDËN ME FRANCËN F. 11

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Greqia thotë se mbështetja e saj për anëtarësimin e Shqipërisë në BE është e kushtëzuar

ATHINË, 18 DHJETOR - Greqia do ta mbështesë Shqipërinë në përpjekjet e saj dhjetëvjeçare për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian, por me kusht që ajo t'i respektojë të drejtat e pakicës greke në vend, tha të mërkurën kryeministri Kyriakos Mitsotakis, raporton "Reuters".

Marrëdhëniet në mes të Athinës dhe Tiranës u përkeqësuan pasi Shqipëria e arrestoi politikanin e pakicës greke, Alfred Beleri, gjatë një fushate për zgjedhjet lokale në qytetin e tij të Himarës vitin e kaluar dhe e burgosi atë për blerje votash.

Beleri u lirua këtë vit pasi fitoi një vend në Parlamentin Evropian si kandidat i partisë konservatore të Mitsotakisit,

Demokracia e Re.

Duke folur në nënshkrimin e një kontrate për një rrugë të re që lidh qytetin veriperëndimor grek të Janinës me fshatin shqiptar Kakavijë, Mitsotakis tha se Greqia gjithmonë ka ruajtur marrëdhënie të mira me fqinjën e saj në Adriatik.

Por, mbështetja e saj për përpjekjet e Shqipërisë për anëtarësim në BE varet nga shpejtësia e përmbushjes së detyrimeve të kahershme që lidhen me pronësinë dhe të drejtat e tjera të pakicës greke në Shqipëri, e cila është më e madhja në vend. "Ekziston një rrugë e vazhdueshme e kushteve drejt Bashkimit Evropian, ku ne jemi në thelb rregullatorët e shpejtësisë me të cilën Shqipëria do të ecë drejt



Evropës", tha Mitsotakis para se të udhëtonte për në Bruksel për samitin BE-Balkan Perëndimor. Shqipërisë, së bashku me Bosnjën, Kosovën, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë, u është premtuar anëtarësimi në BE vite më parë

dhe ato janë në bisedime me BE-në për mënyrën se si të përshtatohen reformat e nevojshme, të cilat do t'i ndihmojnë përfundimisht të bëhen pjesë e bllokut me 27 vende.

Por, procesi ka ngecur, kryesisht

për shkak të përparimit të ngadaltë në reforma dhe gjithashtu për shkak të mungesës së dëshirës nga shtetet anëtare të BE-së për zgjerim të mëtejshëm.

Shqipëria e hapi kapitullin e parë të negociatave për anëtarësim me Bashkimin Evropian në tetor, 15 vjet pasi kishte aplikuar për anëtarësim. Ndërkohë, të mërkurën, pas një takimi me homologun e tij serb, Marko Gjuriq, në Athinë, ministri i Jashtëm grek, George Gerapetritis, tha se Greqia gjithashtu mbështet përpjekjet e Serbisë për t'u anëtarësuar në BE.

"Anëtarësimi i Serbisë në Bashkimin Evropian është një domosdoshmëri gjeopolitike", tha Gerapetritis.

Fletarrestim ndërkombëtar për Artan Grubin

SHKUP, 18 DHJETOR - Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) e Maqedonisë së Veriut ka publikuar fletarrestimet ndërkombëtare të lëshuara për ish-zëvendëskryeministrin Artan Grubi dhe ish-drejtorin e Lotarisë Shtetërore, Përparim Bajrami, të cilët besohet se janë larguar nga vendi.

Fletarrestimet janë lëshuar të mërkurën nga Prokuroria Publike e Maqedonisë së Veriut, pas kërkesës së Gjykatës Themelore, e cila më 17 dhjetor propozoi edhe masën e paraburgimit prej 30 ditësh për të dyshuarit.

Grubi dhe Bajrami akuzohen "për përvetësim të pasurisë



së paligjshme", nga Lotaria Shtetërore, ndërsa dëmi i shkaktuar vlerësohet të jetë rreth 8.2 milionë euro. Sipas

Prokurorisë, Grubi, si i dyshuarit i dytë në këtë rast, ka mundësuar një procedurë të paligjshme për furnizimin

me terminale (VLT), ndonëse ishte në dijeni se Lotaria Shtetërore nuk kishte autorizim për të organizuar lojëra elektronike të fatit në mënyrë të pavarur brenda territorit të Maqedonisë së Veriut.

Policia bastisi shtëpitë e Grubit dhe Bajramit ditë më parë, mirëpo ata nuk u gjetën.

Grubi, i cili më 9 dhjetor u fut në listën e zezë të ShBA-së për korrupsion, i ka mohuar akuzat për arratisje, duke deklaruar se ndodhet jashtë vendit për një "vizitë private". Ai ka shtuar për këtë vizitë e ka informuar edhe sigurimin e tij personal policor.

Ndërkohë, kryeministri

Hristijan Mickoski, ka njoftuar se Artan Grubi së bashku me një biznesmen "është larguar nga Maqedonia e Veriut në drejtim të Kosovës, më 15 dhjetor, me një veturë me targa diplomatike", kurse për Bajramin, ka theksuar se "për një kohë të gjatë është jashtë territorit të Maqedonisë së Veriut". Ndryshe, Kosova dhe Maqedonia e Veriut kanë marrëveshje ekstradimi, e cila është nënshkruar në vitin 2011.

Grubi, ish-deputet, tanimë edhe ish-anëtar i Bashkimit Demokratik për Integritim (BDI), në opozitë, rrezikon të dënohet me burgim deri në pesë vjet nëse shpallet fajtor.

Nissan e Honda, bisedime për t'u bashkuar

TOKIO, 18 DHJETOR - Prodhuesit japonezë të automjeteve, Nissan Motor Corporation dhe Honda Motor Company, kanë konfirmuar të mërkurën se janë duke diskutuar për një bashkëpunim më të ngushtë, teksa kanë mohuar raportimet se kanë vendosur të bashkohen.

Çmimi i aksioneve të Nissan-it u rrit për më shumë se 22 për qind në Tokio, pasi raportimet, që citonin burime të pidentifikuara, thanë se ai mund të bashkohet me Honda-n për të formuar grupin e tretë më të madh prodhues të automjeteve në botë, raporton AP. Çmimi i aksioneve të Honda-s, në anën tjetër, ra për 3 për qind.

Sipas raportimeve, anëtari i

aleancës Nissan, Mitsubishi Motors Corporation, është, po ashtu, i përfshirë në bisedime. Që të tre prodhuesit japonezë të automjeteve njoftuan në gusht se planifikonin të ndanin me njëri-tjetrin komponentë për automjete elektrike, si bateritë, dhe të punonin bashkërisht për programet për ngasje autonome, për t'u përshtatur më mirë ndryshimeve dramatike në industrinë e automjeteve, të përqendruara rreth elektrifikimit.

Një marrëveshje preliminare ndërmjet Honda-s, prodhuesit të dytë më të madh në Japoni, dhe Nissan-it, të tretit, u bë e ditur në mars.

Tregtia me aksionet e Nissan-it u pezullua, por më pas u



kthye pasi kompanitë lëshuan bashkërisht një komunikatë, përmes së cilës thanë se po "shqyrtojnë mundësi të ndryshme për bashkëpunim të ardhshëm, por se nuk është marrë asnjë vendim".

Një bashkim i kompanive

mund të rezultojë në një gjigant me vlerë prej rreth 55 miliardë dollarësh, bazuar në vlerën në treg të të gjithë tre prodhuesve të automjeteve. Bashkimi i forcave do t'i ndihmonte dy kompanive të rrisnin peshën për të garuar

me liderin japonez të tregut, Toyota Motor Corporation, dhe me Volkswagen AG-në e Gjermanisë.

Ngritja e prodhuesve kinezë të automjeteve po e lëkund industrinë në një kohë kur prodhuesit po përballen me telashe në kalimin nga automjetet me lëndë djegëse në ato elektrike.

Toyota ka prodhuar 11.5 milionë automjete më 2023, përderisa Honda ka nxjerrë në treg 4.2 milionë, ndërsa Nissan ka prodhuar 3.4 milionë. Mitsubishi Motors ka prodhuar pak më shumë se 1 milion.

Edhe në rast të një bashkimi, Toyota do të mbetet prodhuesi më i madh japonez i automjeteve.

Mërgata e Kosovës do të mund të votojë në ambasada dhe në konsullata në 22 shtete

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka njoftuar se mërgata e Kosovës do të mund të votojë për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit në ambasada dhe në konsullata në shtetet ku jeton. Në një mbledhje të Qeverisë së Kosovës, të mbajtur të mërkurën, Kurti ka thënë se kjo është bërë e mundur pas ndryshimit të ligjit. "Do të jenë gjithsej 22 kuti postare, në 22 shtete të ndryshme, kurse votimi fizik do të organizohet në 35 përfaqësi diplomatike dhe konsullare në 22 shtete", ka bërë me dije ai.

Kurti i ka bërë thirrje mërgatës të regjistrohet për të drejtën për votim jashtë vendit, teksa ka kujtuar se afati është i hapur deri më 26 dhjetor. "Po i drejtohem mërgatës sonë, nga mbledhja e qeverisë, sepse vota e tyre ka qenë përcaktuese për përbërjen e kësaj qeverie. Siç ka qenë edhe kontributi i saj përcaktues për fatin e mirëqenien e vendit tonë ndër vite", është shprehur ai. "Votimi përmes postës brenda vendit, dhe nëpër



ambasada e konsullata, është fitore e madhe për mërgatën tonë punëtore e patriotike", ka thënë Kurti. Sipas kryeministrit, "deri më tani, padrejtësisht, mërgata është ballafaquar me vështirësi burokratike e barrë financiare, e cila herë ua ka pamundësuar votimin, e herë e ka dekurajuar pjesëmarrjen

në votim".

Diaspora e Kosovës është e përqendruar kryesisht në Gjermani, Zvicër, Austri dhe vende të tjera të Evropës. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, numri i qytetarëve të Kosovës që jetojnë jashtë vendit deri në fund të vitit 2018 ka qenë mbi 850 000.

Ndonëse partitë politike në Kosovë kanë nisur prej javësh takime dhe tubime me diasporën e Kosovës, por edhe me qytetarë brenda Kosovës, me rregulloren e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve periudha e fushatës së zgjedhjeve fillon 30 ditë para ditës së zgjedhjeve.

Në rastin konkret, sipas KQZ-së, periudha e fushatës zgjedhore për partitë politike dhe kandidatët e certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhjet e 9 shkurtit fillon zyrtarisht më 11 janar 2025.

KQZ ka bërë me dije se 28 subjekte politike kanë aplikuar për certifikim për pjesëmarrje në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit. Sipas një njoftimi për medie, pas mbylljes së afatit zyrtar, në mesin e 28 subjekteve politike janë 20 parti politike, pesë koalicionet dhe një kandidat i pavarur.

Në mesin e subjekteve janë parti shqiptare, të komunitetit serb dhe komuniteteve të tjera më të vogla në Kosovë.

KQZ-ja duhet t'i konfirmojë listat më së voni deri më 25 dhjetor.

Zgjedhjet e 9 shkurtit do të jenë zgjedhjet e para të rregullta parlamentare që do të organizohen në Kosovë që nga shpallja e pavarësisë më 2008.

Ku do të mund të votojë mërgata e Kosovës?

Qendrat e votimit në përfaqësi diplomatike të Kosovës për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, që mbahen më 9 shkurt 2025, sipas Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, janë në këto shtete: Australi, Austri, Belgjikë, Çeki, Danimarkë, Francë, Gjermani, Holandë, Hungari, Itali, Kanada, Kroaci, Mal të Zi, Maqedoni të Veriut, Mbretëri të Bashkuar, Norvegji, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Shqipëri, Slloveni, Suedi, Turqi, Zvicër.

Lajçaku: Kosova ta themelojë Asociacionin, Serbia t'i njohë simbolet e Kosovës



PRISHTINË, 18 DHJETOR - Përfaqësuesi i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, ka thënë se ua ka kujtuar Prishtinës dhe Beogradit, të martën në Bruksel, se normalizimi i marrëdhënieve nënkupton integritet në BE, dhe se dy proceset janë të ndërlidhura me njëri-tjetrin.

Lajçaku ka thënë se me kryenegociatorin e Kosovës, Besnik Bislimi, dhe me atë të Serbisë, Petar Petković, kanë diskutuar për hapat drejt zbatimit të Marrëveshjes së Ohrit, teksa ka përmendur "shtensionimin, përgjegjësinë për sulmet e 2023-s, riintegrimin e serbëve të Kosovës, themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, njohjen e dokumenteve dhe simboleve

të Kosovës".

Deklaratat e Lajçakut, të bëra në llogarinë e tij në rrjetin social X, erdhën një ditë pasi Kosova dhe Serbia përmbyllën me sukses negociatat për zbatimin e Deklaratës së vitit 2023 për Personat e Zhdukur gjatë luftës në Kosovë.

Lajçaku ka thënë se dakordimi për zbatimin e Deklaratës për të Pagjeturit ishte "një hap i rëndësishëm që përfundimisht do të sjellë një përmbyllje për familjet". Sipas Kryqit të Kuq, në Kosovë janë ende 1 612 persona të pagjetur nga lufta. Emisari evropian ka paralajmëruar se Brukseli së shpejti do të jetë mikpritës i takimit të parë të një Komisioni të Përbashkët, ndërkaq Bislimi ka thënë se ky komision do të fillojë të

merret me çështjet që i takojnë nga janari i 2025-s.

Kosova dhe Serbia arritën marrëveshje më 2023 për Deklaratën e përbashkët për personat e zhdukur, në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian. Zotimet që u bënë me këtë deklaratë përfshijnë: qasje të plotë në informacione të besueshme, mes tyre edhe ato me status të klasifikuar; vënie në dispozicion të të gjitha dokumenteve me rëndësi për përcaktimin e fatit të personave të zhdukur, si dhe punë të përbashkët përmes një komisioni të kryesuar nga Bashkimi Evropian. Por, deri tani, asnjë prej këtyre nuk është realizuar në praktikë.

Konjufca priti në takim lamtumirës ambasadorin amerikan Jeffry Hovenier

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të mërkurën në takim lamtumirës ambasadorin amerikan Jeffry Hovenier. Duke e falënderuar për vizitën, kryeparlamentari Konjufca i shprehu mirënjohje për angazhimin përgjatë mandatit të tij në Kosovë, ku ka dhënë kontributin e tij shumë të rëndësishme në

rritjen e bashkëpunimit mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Republikës së Kosovës, me përkushtim ndaj ruajtjes dhe avancimit të interesave tona të përbashkëta.

Po ashtu, kryetari Konjufca nënvizoi se ashtu si gjatë mandatit të ambasadorit Jeffry Hovenier, institucionet tona shtetërore do të jenë plotësisht të angazhuara, me

konsideratë dhe mirënjohje të thellë, për të forcur gjithnjë e më shumë raportet me aleatin tonë më të madh, ShBA-në, që ka një kontribut dhe rol të pazëvendësueshëm në vendin tonë.

Konjufca e përgëzoi ambasadorin Hovenier për punën e tij të mirë të deritanishme dhe i uroi atij suksese sa më të mëdha në angazhimet e tij ardhshme.





Bujar Teretana (RFE)

Municionet 'Made in Kosova', një ambicie ende e largët

Këto ditë kishte shumë bujë për marrëveshjen ndërmjet Kosovës dhe Turqisë për ndërtimin e fabrikës së parë të municionit në Kosovë. Edhe pse shumëçka rreth saj mbahet sekret, për ministrin e Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ky do të jetë një hap shumë i rëndësishëm drejt fuqizimit të kapaciteteve ushtarake të vendit. Fabrika e paralajmëruar e municioneve, sipas tij, do të krijojë jo vetëm aftësi vetjake të mbrojtjes, por edhe mundësi eksporti

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Këto ditë kishte shumë bujë për marrëveshjen ndërmjet Kosovës dhe Turqisë për ndërtimin e fabrikës së parë të municionit në Kosovë. Edhe pse shumëçka rreth saj mbahet sekret, ky artikull sjell përgjigje në së paku disa pyetje: kur mund të funksionalizohet fabrika dhe çfarë hapash duhet të ndiqen për të përfutur prej saj? Në kohën e pasigurive rajonale dhe tensioneve globale, Kosova i ka vendosur vetes një objektivi: prodhimin e municioneve. Për ministrin e Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ky do të jetë një hap shumë i rëndësishëm drejt fuqizimit të kapaciteteve ushtarake të vendit. Fabrika e paralajmëruar e municioneve, sipas tij, do të

krijojë jo vetëm aftësi vetjake të mbrojtjes, por edhe mundësi eksporti. Ekspertët e sigurisë, në anën tjetër, kanë shprehur rezerva, pasi disa thonë se do të duhen vite kohë për përmbushjen e kësaj ambicieje, të tjerë favorizojnë rritjen e bashkëpunimit rajonal.

Çfarë synon Kosova?

Me një marrëveshje të nënshkruar më 16 dhjetor me kompaninë turke të armëve, MKE, Kosova synon të ndërtojë një fabrikë të municioneve të kalibrave të ndryshëm - të parën në vend. Maqedonci nuk jep detaje se ku dhe kur pritet të nisë prodhimin, duke thënë se informacionet e tilla janë të klasifikuara, por

shpreh bindjen se me jetësimin e saj Kosova nuk do të jetë më e varur për municione. "Ne, normalisht, nuk mund të bëhemi 100 për qind të vetëqëndrueshëm, por mund ta zvogëlojmë varësinë nga vendet e tjera, duke prodhuar municione apo armatime, të cilat shpenzohen më shumë dhe sigurohen më vështirë", ka thënë ai për "Radion Evropa e Lirë".

Maqedonci ka treguar se, fillimisht, do të prodhohen municione 5.56 milimetra dhe 7.62 milimetra, të cilat përdoren edhe nga Forca e Sigurisë së Kosovës, edhe nga Policia e Kosovës. Ai ka thënë se fabrika do të drejtohet nga shteti, por se "është e rëndësishme të ketë edhe investitorë privatë për ta rritur prodhimin". "Në atë mënyrë do të sigurojmë furnizime të qëndrueshme për nevojat e brendshme, por do të jemi në gjendje edhe të eksportojmë në vendet partnere, varësisht kërkesave të tyre", ka thënë ministri i Mbrojtjes. Disa përfaqësues të opozitës kanë shprehur dyshime se ky projekt do të realizohet. Për Rashit Qalajn, anëtar i Komisionit për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes në Kuvendin e Kosovës, vetë nënshkrimi i kontratës me një

kompani turke është i diskutueshëm. "Unë mendoj se për çdo gjë që ka të bëjë me armatimin dhe municionet, ne duhet të orientohejmë nga partneri ynë strategjik: ShBA-ja", ka thënë ai. Por, Maqedonci ka siguruar se në krejt këta hapa, Kosova e ka mbështetjen e NATO-s - aleancës ku mëton të anëtarësohet - përfshirë edhe të ShBA-së. Kosova, me 1.5 milion banorë, ka Forcën e saj të Sigurisë, e cila është në proces të shndërrimit në ushtri të rregullt dhe pritet t'i ketë mbi 7 500 pjesëtarë aktivë dhe rezervistë, si dhe policinë me rreth 9 000 pjesëtarë. I pranishëm në vend është edhe misioni paqeruajtës i NATO-s, KFOR.

A mund të bëhet Kosova e vetëqëndrueshme me municion?

Ish-zyrtari i NATO-s, Jamie Shea, ka thënë se përmbushja e kësaj ambicieje varet nga së paku tre faktorë - jo të arritshëm në afat të shkurtër. Municioni ka nevojë për kimikate për eksplozivë, për metale speciale dhe për lëndë të para, që shpesh vijnë nga Kina. Fillimisht ai ka thënë se Turqia duhet të pajtohet për transferimin e teknologjisë dhe

të licencave të saj në Kosovë, në mënyrë që ajo t'i zhvillojë aftësitë e veta mbrojtëse. Pastaj duhet siguruar zinxhiri i pavarur i furnizimeve, që mund të marrë vite kohë. "... sepse municioni ka nevojë për kimikate për eksplozivë, për metale speciale dhe për lëndë të para, që shpesh vijnë nga Kina dhe vende të tjera", ka thënë Shea për "Radion Evropa e Lirë". "Gjërat mund të komplikohen edhe më nëse municioni që prodhohet, përfshin predha dhe raketa që varen nga mikroprocesorë dhe aparatura të tjera të sofistikuar elektronike", ka thënë ai. Si faktor të tretë të rëndësishëm, që Kosova duhet ta marrë në konsideratë, Shea ka përmendur përfitimet. Ai ka thënë se Kosovës do t'i duhej të eksportoje patjetër municione në mënyrë që atë kapital ta investojë në mbështetje të industrisë së saj të mbrojtjes. Një treg potencial për eksporte, sipas Sheas, mund të jetë vetë Turqia, sidomos nëse fabrika në Kosovë operon si strukturë e saj në vend të huaj. "E pasi të filloni të prodhoni sasi të mëdha municionesh, ruajtja e sigurt e tyre bëhet një çështje tjetër madhore, por edhe dobësi e mundshme. E mbani mend shpërthimin masiv të një depeje municionesh në Tiranë,

Haxhi Shala pranon fajësinë para gjykatës në Hagë

Sipas marrëveshjes për pranimin e fajësisë, për Shalën propozohet një dënim me tri vjet burgim, në të cilin llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim

HAGË, 18 DHJETOR - Ish-eprori i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Haxhi Shala, është deklaruar fajtor të mërkurën para Gjykatës Speciale në Hagë për akuzën e frikësimit të dëshmitarit dhe pengimit të drejtësisë. Këtë deklaram ai e bëri në kuadër të një marrëveshjeje për pranimin e fajësisë me Prokurorinë e Specializuar, ku u pajtua edhe për një dënim me burgim deri në tri vjet.

Kjo prokurori e akuzon Shalën se kreu veprën në bashkëpunim me Sabit Januzin dhe Ismet Bahtijarin. "Kur jam deklaruar jo i fajshëm, nuk kam qenë i intervistuar nga Prokuroria dhe nuk kam qenë i informuar se për çfarë është fjala. Tani deklaram fajtor për çfarë thuhet në marrëveshjen e fajësisë", tha

Shala në gjykatë, aktakuza e të cilit ishte konfirmuar pas rishikimit më 10 korrik 2024. Brenda kësaj marrëveshjeje, për Shalën propozohet një dënim deri me tri vjet burgim, në të cilin llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim. Shala u arrestua më 11 dhjetor 2023, dhe një ditë më vonë u transferua në qendrën e paraburgimit në Hagë.

Në rast se paneli gjyqësor pranon këtë marrëveshje të palëve dhe në rast se dënimi për Shalën do të jetë tre vjet burgim ose më i ulët, palët nuk do të kenë të drejtë apelimi. "Sa më i ulët dënimi, aq më mirë", tha Shala gjatë deklaramit të tij në gjykatë.

Shala u pajtua edhe me pikat e tjera të marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe deklaroi se e ka arritur atë "me

vullnet të lirë dhe pa detyrim". Gjykata është paraparë që më vonë gjatë ditës ta shqyrtojë edhe marrëveshjen për pranimin e fajësisë së Sabit Januzit.

Në anën tjetër, edhe Ismet Bahtijari arriti një marrëveshje të ngjashme për pranim të fajësisë, sipas njoftimit të 18 dhjetorit. Kjo marrëveshje pritet të shqyrtohet nga gjykata në një seancë më 19 dhjetor.

Çfarë thotë marrëveshja për pranimin e fajësisë së Haxhi Shalës?

Brenda marrëveshjes së Shalës thuhet se në periudhën midis 5 dhe 12 prillit 2023, Shala, bashkë me Sabit Januzin dhe Ismet Bahtijarin, kontaktuan një dëshmitar. Tutje, sipas marrëveshjes, thuhet se pjesëtarë të grupit bënë vizita në shtëpinë e dëshmitarit dhe i ofruan përfitime në këmbim të tërheqjes së dëshmisë së tij. Sipas Prokurorisë, vepra në grup u krye nën direktivën e Shalës.

Deri më tani nuk është bërë publike se për cilin dëshmitar bëhet fjalë apo në cilin rast ka dëshmuar ai. Paraprakisht, Shala ishte deklaruar i pafajshëm në këtë akuzë, e cila u konfirmua më 4 dhjetor 2023. Dhomat e Specializuara të Kosovës deri më tani kanë shpallur dy aktgjykime për pengim në administrim të drejtësisë.

Dy ish-figura të Organizatës së Veteranëve të UÇK-së, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj, janë dënuar për pengimin e drejtësisë deri tani.

Ndërkaq, më 6 dhjetor 2024 Gjykata Speciale në Hagë konfirmoi një aktakuzë të re kundër ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, si dhe kundër katër personave të tjerë për vepra penale që lidhen me "pretendime për përpjekje të paligjshme për të ndikuar në dëshmitë e dëshmitarëve në gjykimin e krimeve të luftës Thaçi dhe të tjerët".

Dhomat e Specializuara të Kosovës kanë deklaruar aktakuza u konfirmua kundër Hashim Thaçit, ish-ministrit të

Drejtësisë, Hajredin Kuçi, ish-shefit të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, Bashkim Smakaj, ish-kryetarit të Malishevës, Isni Kilaj, dhe Fadil Fazliut.

Ndërkohë, Specialja ka shqiptuar edhe dy aktgjykime për krime lufte.

Gjykata Speciale u themelua në vitin 2015 nga Kuvendi i Kosovës dhe është pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës, por vepron me personel ndërkombëtar dhe ka selinë në Hagë.

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar hetojnë krimet e pretenduara të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të kryera kundër pakicave etnike dhe rivalëve politikë që nga janari i vitit 1998 deri në dhjetor të vitit 2000.

Aktualisht, në Dhomat e Specializuara janë duke u zhvilluar disa raste gjyqësore, përfshirë edhe rasti ndaj ish-kryerëve të UÇK-së - Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi - që akuzohen për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.



disa vjet më parë? Ajo ngjarje çoi në krizë politike në atë vend", ka kujtuar Shea.

Rëndësia e bashkëpunimit rajonal

Ish-ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë, Fatmir Mediu, ka thënë se arritja e vetëqëndrueshmërisë në mbrojtje është e vështirë qoftë për shkak të standardeve të larta që kërkohen, qoftë për koston që ka kjo industri. "Çështja nuk është vetëm të prodhosh e të blesh. Më e

rëndësishmja është mirëmbajtja, e cila ka një kosto jo të vogël", ka thënë ai. Ai ka sugjeruar që Kosova ta rrisë bashkëpunimin me shtetet anëtare të NATO-s në rajonin e Ballkanit - përfshirë këtu Shqipërinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut - dhe në këtë mënyrë t'i rrisë nivelet e veta operationale.

Kjo strategji ka thënë se quhet "smart defence" apo "mbrojtje e zgjuar" dhe krijon siguri më të madhe përmes bashkëpunimit më të madh.

Në mesin e vendeve që e shfrytëzojnë atë, Mediu ka

përmendur shtetet baltike: Lituaninë, Letoninë dhe Estoninë. "Çështja nuk është vetëm të prodhosh e të blesh. Më e rëndësishmja është mirëmbajtja, e cila ka një kosto jo të vogël. Ndaj një bashkëpunim rajonal do të ishte shumë herë më i vlefshëm sesa të mendojmë të ndërtojmë diçka të vetëqëndrueshme", ka thënë Mediu për "Radion Evropa e Lirë".

Tani anëtar i Asamblesë Parlamentare të NATO-s, ai ka thënë se kjo qasje do t'i shpaguej Kosovës, marrë parasysh aspiratat e saj për t'u

anëtarësuar në NATO dhe nivelin e lartë të bashkëpunimit që kërkon kjo aleancë.

"Në këtë plan unë mendoj se ka shumë hapësirë për të ecur me prokurime të përbashkëta dhe me 'smart defence'", ka thënë Mediu.

Investimet në mbrojtje

Buxheti për Ministrinë e Mbrojtjes në Kosovë do të jetë 207.8 milionë euro në vitin 2025, apo 54 milionë euro më shumë sesa këtë vit.

Maqedonci thotë se në tre vitet e kaluara Kosova ka shpenzuar

mbi 239 milionë euro për blerje të armatimit, e "nëse përfshihen edhe blerjet e këtij viti, shuma kalon mbi 269 milionë euro".

Për shkak të ndjeshmërisë së informacionit, ai nuk ka dhënë detaje se nga janë blerë. Por, ajo që dihet është se Kosova vitet e fundit ka siguruar armë edhe nga dy fuqi të NATO-s: ShBA-ja dhe Turqia.

Në mars të vitit 2022 ajo ka themeluar edhe Fondin e Sigurisë, ku qytetarë dhe donatorë të ndryshëm mund të kontribuojnë për mbrojtjen, por se sa është vlera e tij, nuk dihet dhe nuk bëhet publike.

BABADIMRI I LV-së, DORËLIRI UBO!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Sondazhet dhe shantazhet: Na duhen 500.000 vota për ta vazhduar dinamikën e reformave dhe, si patriotë të Bangladeshit që janë kërkojnë pavarësi të plotë nga Lista Serbe që udhëhiqet nga zemlaku i ZdraVVo Mimoza, mercenares së të gjitha qeverive që nga përfundimi i luftës e deri më sot që nuk i mungon as përvoja ndërkombëtare në Afrikë, te kolonel Gadafi. As operacioni më i sofistikuar plastik nuk do të kishte sukses t'ju lirojë nga skuqja në rast se pafytyrësisht kërkon 500.000 vota për ta "fituar" lirinë nga Lista Serbe në kohën kur mercenarja, së fundi e Kurtit, sigurisht me urdhër të tij, mban të hapur 24 orë hot line politik me Radoiçiqin për ta siguruar përkrahjen kundër veteranëve të luftës, kundër UÇK-së, kundër rritjes së pagave sepse, në të kundërtën do të bie qeveria Kurti 2 dhe Radoiçiq nuk do ta përfundonte vilen e tij buzë Ujmanit. Një herë të poshtë, përjetësisht të poshtë edhe nëse i fitojnë 5.000.000 vota nuk do ta fitojnë lirinë nga Lista Serbe sepse, piten e kanë ngrënë por tepsia (hot line politik midis dy zemlakëve, mercenares ZdraVVo Mimoza dhe Radoiçiqit janë shndërruar në vepra të përjetshme të këtyre të pafytyrëve)! Mos harroni, lexues të nderuar se këto perversitete politike kanë ndodhur pasi Radoiçiq hyri në Listën e Zezë të Departamentit të Shtetit amerikan!!! Ajnshtajni thoshte se mençuria e ka një kufi kurse injoranca, poshtërsia dhe pafytyrësia nuk kanë asnjë kufi. Ku do të gjeni dëshmi më të mirë për këtë se thirrja për 500.000 vota për ta fituar lirinë nga Lista Serbe, në emër të patriotizmit, asnjëherë të dëshmuar shqiptar.

Matrapazë, kontrabandistë flamujsh, mohues të bashkimit kombëtar, ringjallës të nostalgjisë jugosllave dhe karrieristë të pamoralshëm. Të paafte të certifikuar. Hajdutë serikë. I patën mbi 50 për qind të votave, asnjë kundërshtim opozitar, kushte dhe mjedis përrallorë për të bërë punë të mira. 12 miliardë euro buxhet, përkrahje nga Sholci, Macroni, Anglia, nga Sleeping Joe në largim, nga gjyshi Dendias, gjaku politik dhe thuaja edhe kombëtar i Dejana Mihalit, nga Italia dhe, përmes Radoiçiqit edhe nga Serbia. Borrelli e sidomos Hovenieri, i dribluar keq nga Albini, e konsideronin si djalë të vetin politik. Mediat kryesore në Kosovë e ndihmuan Albinin të shkelë pragun e 50 përqindshimit dhe për këtë u shpërblyen rrastë, me para dhe poste, punësime të familjes së ngushtë, poste ambasadorësh për llaskucët siç ishte lehësi kurtian që vazhdon të njëjtën muzikë në Bruksel. Grante nga Peci i Albinit, analiza nga "prof. dr" Ramçe, me parë të Albinit, përkrahje nga antikombëtarët Taravari dhe Besnik Koqja, nga proserbi Abazović, nga rrogëtarët e Luginës, nga kryehajduti Berishaj i Malësisë së Madhe dhe, me një fjalë sofrën e kishin plotë "Bukë e Zemër". Gjatë qeverisë Kurti 1 edhe faleshin dështimet shkaku i shkurtimit të dhunshëm, për mua të pamoralshëm të mandatit nga opozita e grenellizuar. Prandaj edhe kërkuar mandatin e dytë, prandaj edhe e kaluan 50 përqindshin. Edhe atëherë Albini e përdori mashtrimin psikologjik "na duhen mbi 50 për qind për të marrë vendime, nën 50 për qind nuk marrim vendime.". I morën votat me mashtrim, tash

kërkojnë 500.000 vota për t'u liruar nga Lista Serbe! Çfarë mashtrues që janë! Pa Listën Serbe nuk do të zgjidhej Sherife Osmani presidente e as qeveria Kurti 2. Pa LS-në e ZdraVVo Mimoza do të mbetej pa oksigjen politik për ta përfaqësuar Kurtin në marrëveshjet e ndyra kundër veteranëve të luftës dhe UÇK-së. Dhe shumë poshtërsi të tjera.

Sondazhi bëhet më 9 shkurt, këto të UBO-së janë shantazh: Thellësisht jam i bindur se asnjë parti nuk e arrin 40 përqindshin e votave të përgjithshme, madje nëse nuk ndodhë diçka e paparashikueshme, 30 përqindshin është shkalla më e lartë. Partia fituese nuk do ta përcaktojë formimin e qeverisë e as të koalicioneve përkundrazi, do t'i nënshtrohet partisë / partive jofituese. Nuk e besoj se partitë jofituese do të refuzojnë koalicion me LV-në (apo partia Louis Vitton, me para të shtetit), përkundër deklarimeve të forta. Nëse ndërkombëtarët nuk do ta luajnë rolin e ndrikullës gjatë lindjes së qeverisë së ardhshme. Unë nuk bëj sondazhe por kam metodën time të analizës dhe rezultatet janë shumë të përafërta. LV-ja mund t'i i fitojë 47 për qind të votave vetëm nëse votojnë maksimalisht 650 - 700.000 votues dhe LV-ja fiton 350.000 vota. Votat e diasporës më nuk mund të peshkohen si më parë, janë mbyllur deri në një masë të durimit mundësitë e keqpërdorimit ndonëse analfabetja politike Shvarc bëri përpjekje për manipulim me vota dhe votues. Prandaj ka bërë spastrime etnike në ministrinë duke larguar shqiptarët dhe ata me përcaktim kombëtar dhe duke

instaluar frymën dhe mendësinë jugosllave dhe antikombëtare. LV-ja për ekonomi nuk ka çka të flet, madje as me rrejtë nuk ka hapësirë, në politikën e jashtme është më keq se të udhëhiqej nga Daçiç, asnjë njohje, asnjë anëtarësim. Arsimi është i barazvlefshëm me analfabeten Nagavci sikur që shëndetësia është e grimosur sikur mashtruesi i pispillosur, Arben Vitia. Paramilitari Hekuran Murati është dhunuesi dhe vrasës i dytë i veteranëve të luftës dhe të UÇK-së. Rozeta Hajdari është një e paditur ekstreme dhe një viager e korrupsionit. Komandant Pasuli i FSK-së, që nga koha kur flitej për zgjedhje të parakohshme, më shumë është sjel si kandidat për deputet i LV-së, se si ministër i mbrojtjes. Hajrullah Çeku, me krenari dhe dinjitet vendosmërisht është besnik i emrit. Është teleban i nepotizmit dhe korrupsionit. Për pjesën tjetër të kabinetit, tjetër herë. Këtë mandat i kemi dy koalicione multi-etnike që besnikërisht ngajjnë me Boron dhe Ramizin, Mimoza me Millanin dhe Arbri me Radoicën, flasin si loçka, pinë dhe këndojnë bashkë sikur të një gjaku, me një fjalë atë që nuk e ka bërë bashkësia ndërkombëtare që nga përfundimi i luftës, me shumë investime materiale, e ka bërë interesi politik dhe lufta për pushtet! Jemi rast vërtet sui generis. LV-ja përkatësisht Albin Kurti si armë për kuti të votimit do ta përdorë veriu e Kosovës përkatësisht sovranizimin e saj që e ushtron 100 për qind me polici. Për militant ky është ushqim i mjaftueshëm nga menyje e mastershefit Albin, që edhe ashtu e ka vetëm një ushqim, folklorin si ushqim, trushpërlarjen si

oksigjen! Jam i bindur se pikërisht veriu është dështimi më i madh i Albinit, aty pas zgjedhjeve do t'i bëjë lëshimet më të mëdha! Ose këto lëshime do t'ia lë si trashëgimi qeverisë që nuk do të udhëhiqet nga Kurti. Argumenti tjetër për të fituar vota është urrejtja e madhe ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, të cilët vazhdimisht i fajëson për dështim të shtetit ndonëse ata ia sollën lirinë dhe ia krijuan shtetin, të mirat e të cilit maksimalisht po i përdorë dhe keqpërdorë. Në Kuvendin e ardhshëm do të jenë LV-ja, dukshëm e dobësuar, LDK-ja, dukshëm e forcuar, PDK-ja mirë e forcuar, AAK-ja e rritur për së paku 2 për qind dhe, me gjasa të mëdha edhe Lista për Familjen. Për sa rriten këto parti, do të shembet LV-ja. Sondazhin e UBO-së e pritën me entuziazëm këta të LV-së, mendermethënë partisë Guxo dhe Alternativa ZdraVVo Mimoza. Në mungesë të oborrit mbretërorë, shumë deputetë të pushtetit por edhe të opozitës, që për një mandat të plotë luanin rolin e palaços, do të mbesin të papunë. Medet për ta!

E premtja me ters: Albin Kurti nuk e bënë hesap askënd, as Prokurorinë e Shtetit. E thirrën si dëshmitar për inxhe Rozafën, nuk shkoi. Urdhëroi prokurorët të vizatohen në zyrën e KM ku te dera i pret i biri i Ali Milicit të Serbisë, tash defaxhi i Kurtit. Albini është hajgarexhi i madh, ia kalon edhe Baster Kitionit. Kësaj të premtë, para apo pas xhumasë, Albin Kurti do të shkojë në Prokurori. Ftesën e ka. Pastaj, e ka një ofertë e cila nuk mund refuzohet!

Policia sekuestron në Prishtinë monedha 1 dhe 2 euro që dyshohen të jenë të falsifikuara

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Në raportin 24-orësh të Policisë së Kosovës bëhet me dije se nga persona të ndryshëm në Prishtinë janë pranuar para në

monedha nga 1 dhe 2 euro që dyshohet se janë të falsifikuara. Rasti ka ndodhur nga data 10 dhjetor deri më 17 dhjetor.

“Prishtinë /10-17.12.2024. Është raportuar se nga persona të ndryshëm janë pranuar para në monedha nga 1 dhe 2 euro që dyshohet se

janë të falsifikuara. Paratë janë sekuestruar nga krim teknika për t’iu nënshtruar procedurave të mëtejme hetimore”, thuhet në raport.



Kosova bëhet me Muze të Gjenocidit dhe Përtpjekjes për Liri

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Qeveria e Kosovës ka miratuar themelimin e një Muzeu të Gjenocidit dhe Përtpjekjes për Liri, me qëllim “dokumentimin dhe prezantimin e krimeve të ish-Jugosllavisë dhe të Serbisë ndaj shqiptarëve dhe të tjerëve në Kosovë”.

Në mbledhjen e qeverisë, të mbajtur të mërkurën, u tha se objektivi kryesor është “krijimi i një institucioni publik, përkujtues dhe prezantues të historive dhe përvojave nën pushtimin e Serbisë dhe të Jugosllavisë”.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se muzeu “është institucionalizimi i kujtesës sonë kolektive dhe dëshmi, sa e krimeve monstruoze të Serbisë gjenocidale, aq edhe dëshmi se Republika e Kosovës edhe ka ngadhënjyer, edhe nuk harron”.

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit i Kosovës, Hajrulla Çeku, tha se muzeu i ri synon edukimin, përkujtimin dhe nderimin e brezave dhe prezantimin e përjetimeve të të mbijetuarve, që historitë e tyre



të mos harrohen.

Muzeu, shtoi ai, “synon paqen e qëndrueshme, duke u siguruar që e kaluara e dhunshme të jetë e dëshmuar, të kujtohet dhe të mos përsëritet”.

Çeku ka thënë se ky muze do të themelohet fillimisht si njësi e veçantë në kuadër të Muzeut

Kombëtar të Kosovës. “Vendi ynë do të ketë një muze të dinjitetshëm ku do të dokumentohen dhe prezantohen krimet e ish-Jugosllavisë dhe Serbisë ndaj shqiptarëve dhe të tjerëve në Kosovë. Në mbledhjen e sotme të qeverisë u miratua propozim-vendimi që i hapë

rrugë themelimit të këtij muzeu. Fillimisht themelohet si njësi e veçantë në kuadër të Muzeut Kombëtar të Kosovës, e pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Muzetë, si institucion i pavarur muzeal i nivelit kombëtar. Ne do t’i ndërmarrim të gjithë hapat përkatës për hartimin e konceptit muzeor dhe

kuratorial, si dhe për projektin arkitektonik dhe hapësinor të ndërtesës së Muzeut. Institucioni do të vendoset në ndërtesën ku aktualisht është Ministria e Kulturës, ndërsa paralelisht do t’i zhvillojmë procedurat për zhvendosjen e administratës në një ndërtesë tjetër ose një të re. Do të krijojmë një institucion reprezentativ dhe të nivelit botëror”, ka thënë Çeku.

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Muzetë, ai pritet të shndërrohet në institucion të pavarur muzeor të nivelit kombëtar. Institucioni i muzeut synohet të vendoset në ndërtesën ku aktualisht vepron MKRS, në sheshin “Nënë Tereza” në Prishtinë.

Propozimi për themelimin e muzeut u mbështet nga të gjithë ministrat e pranishëm në mbledhje, me përjashtim të atij për Komunitete dhe Kthim, Nenad Rashiç, i cili abstenoj në votim.

Gjatë luftës së fundit në Kosovë më 1998-'99 janë vrarë mbi 13 000 civilë dhe mijëra të tjerë janë zhdukur. Mbi 1 600 persona vazhdojnë të jenë ende të pagjetur, pjesa më e madhe e tyre shqiptarë.

Komuna e Rahovecit ndalon përdorimin e mjeteve piroteknike në hapësirat publike



RAHOVEC, 18 DHJETOR - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka bërë me dije se gjatë festave të fundvitit ka urdhëruar ndalimin e përdorimit të mjeteve piroteknike në hapësirat

publike në këtë komunë. “Zbatimi i këtij vendimi do të mbikëqyret nga inspektorët dhe policia, ndërsa shkelësit do të ndëshkohen me gjobë prej 100 eurosh”, ka shkruar Latifi në “Facebook”.

Hamza: Në qeverinë time pensionistët do ta kenë kujdesin dhe sigurinë që e meritojnë



PRISHTINË, 18 DHJETOR - Kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës për kryeministër, Bedri Hamza, ka thënë se në qeverisjen e tij pensionistët do ta kenë kujdesin, respektin dhe sigurinë që e meritojnë. Ai gjatë një takimi me pensionistë tha se në mandatin e tij do të ketë rritje të pensionit bazikë. “Qysh mundet një i moshuar me mbyll muajin me 120 euro? Është e pamundur...”, tha ai, duke shtuar se do të ketë rritje me ardhjen e tij kryeministër. “E kam thënë 70 për qind, domethënë atë pragun minimal të rritjes”, ka pohuar Hamza.

Përfundoi me sukses seria e 10 tryezave për barazi gjinore në proceset zgjedhore

PEJË, 18 DHJETOR - Përfaqësues nga komunat Pejë, Klinë dhe Istog kanë ndarë ide dhe diskutuar mbi përmirësimin e përfaqësimit të grave dhe

vajzave në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit 2025. Diskutimet konstruktive gjatë tryezës së rrumbullakët të organizuar në Pejë nga

KQZ-ja në bashkëpunim me OSBE-në dhe RRGK-në e përçuan sërish mesazhin për rolin e grave në demokraci. Ky cikël prej 10 tryezash të

rrumbullakëta solli në fokus zgjidhje konkrete për një përfshirje më të barabartë dhe gjithëpërfshirëse të grave dhe vajzave në proceset demokratike.



Peci: E mora Ministrinë e Bujqësisë me 41 milionë euro borxhe, do t'ia dorëzoj pasardhësit me 110 milionë në dispozicion

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Ministri i Bujqësisë, Faton Peci, ka thënë të mërkurën se drejtimin e ministrisë e mori me 41 milionë euro borxhe, ndërsa do t'ia dorëzojë pasardhësit me 110 milionë euro në dispozicion.

Peci në "Facebook" ka shkruar se viti 2022 ka qenë viti i parë ku është shpërguar për sërë herë në tërësi djersa dhe munda i fermerit. "Edhe 14 milionë euro shtesë për bujqësinë! Mora drejtimin e ministrisë me

41 milionë euro borxhe, ndërsa do ia dorëzoj pasardhësit në Ministrinë e Bujqësisë 110 milionë euro në dispozicion. Me marrjen e mandatit si ministër i Bujqësisë, jam përballur me vështirësinë nr. 1 e që ka qenë buxheti i disponueshëm në vlerën 0 euro ndërsa borxhet e obligimet e lëna nga paraardhësit tejkalonin vlerën e 40 milionë eurove. Viti 2022, ka qenë viti i parë ku është shpërguar për sërë herë në

tërësi djersa dhe munda i fermerit. Kjo ka pasuar edhe gjatë: Vitit 2023 - 0 borxhe ndaj fermerëve", ka thënë ai, duke shtuar se do të përmbillet suksesshëm edhe për viti 2024 me zero borxhe ndaj fermerëve në kategorinë e pagesave direkte/subvencioneve. "Unë kam pasur fat sfidues që në vitin 2021 t'i trashëgoj mbi 40 milionë euro borxhe, obligime e detyrime mirëpo ndihem krenar që si rezultat i përkushtimit dhe menaxhimi

të përgjegjshëm të financave publike, ministri i ardhshëm i Bujqësisë në vitin 2025, nuk do të trashëgojë obligime mirëpo do t'i ketë në dispozicion 110 milionë euro buxhet. Nga këto, 90 milionë euro janë buxhet nacional, ndërsa 20 milionë euro të siguruar nga donatorët e organizatat ndërkombëtare. Falënderoj kryeministrin Albin Kurti dhe ministrin e Financave Hekuran Murati për mbështetjen e vazhdueshme karshi sektorit të bujqësisë.



Nga borxhet, korrupsioni dhe zhvatja tek mundësitë, transparenca dhe mundësitë e barabarta", ka shkruar ministri Peci në "Facebook".

Lansohet ankandi i parë për energji nga era me kapacitet 100 MW

EPOKA E ENJTE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Kryeministri Albin Kurti, ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli dhe partnerët e projektit kanë bërë të mërkurën lansimin e Ankandit të Parë të Erës 100 MW. Sipas tyre, lansimi i Ankandit është një hap jashtëzakonisht i rëndësishëm për sigurimin e energjisë nga burimet e ripërtërishme.

Kryeministri Kurti deklaroi se fati është që Kosova ka potencial të madh natyror për energji të ripërtërishme. "Deri në vitin 2031 jemi zotuar t'i arrijmë kapacitetet prej 1600 MW nga burimet e ripërtërishme të energjisë - të pastra e me procedura konkurruese që përkthehen në çmime më të mira për qytetarët tanë. Ankandi diellor është zbatuar mbi këtë zotim dhe ka dëshmuar përparësitë e mëdha të skemave të kështilla: me konkurrencë të shëndetshme, çmimi për blerjen e energjisë është ulur për 35% krahasuar me çmimin tavan, e tërë ky përfitim u shkon qytetarëve dhe bizneseve tona", ka theksuar Kurti.

Diversifikimi dhe shumëfishimi i burimeve të energjisë përmes



energjisë së ripërtërishme, sipas kryeministrit, është edhe domosdoshmëri për ta mbrojtur pavarësinë energjetike të Kosovës. Ministrja Rizvanolli tha se ky projekt është i rëndësishëm për prodhimin e energjisë nga era për shkak të nevojave që ka treguar për energji. "Është tejet e rëndësishme që kërkesa jonë për energji, veçanërisht në orët e mbrëmjes dhe veçanërisht gjatë muajve të ftohtë, përkon shumë mirë me profilin e prodhimit të energjisë nga era, andaj ky lloj projekti është i rëndësishëm për gjenerimin

dhe për ekonominë tonë", ka thënë ajo. Sipas saj, Kosova ka potencial të jashtëzakonshëm për energji të erës teksa tregoi më shumë për shpejtësinë që arrijnë ato në zona të ulëta e malore. "Kosova jemi me fat që është një vend që ka potencial të jashtëzakonshëm për energji të erës. Rreth 17% e territorit të Republikës së Kosovës ka erëra të qëndrueshme me shpejtësi mbi 6 m/s, kurse në zona malore arrin deri në 8 m/s, duke krijuar kështu kushte optimale për ndërtimin e kapaciteteve të erës mbi mesataren e shumë vendeve

evropiane", tha ministrja. Pas lansimit të fazës së parakualifikimit për ankandin e Parë të Erës, do të pasojë faza e ofertave financiare. Ministrja Rizvanolli gjatë fjalimit tha se në garë do të marrin pjesë kompani të kualifikuara e të motivuara për investime. "Këtë garë zotohemi ta udhëheqim në mënyrë të drejtë e transparente siç kemi bërë edhe në ankandin e parë në mënyrë që të sigurohemi se cilado që të jetë kompania ose konzorciumi që përzgjidhet përfundimisht për ndërtimin e Parkut të Erës, fituesi më i

madh përfundimisht të jetë qytetari i Republikës së Kosovës, me çmim të përbalueshëm, energji të pastër dhe energji të sigurt", ka deklaruar ajo.

Hapjen e këtij ankandi e mirëprititi zëvendësambasori gjerman në Kosovë, Mathias Conard. Ndërsa drejtoresha e Misionit të USAID-it në Kosovë, Eileen Devit, ka pohuar se ky ankand është një shembull i mirë që po tregon Kosova.

E drejtori regional për Ballkanin Perëndimor nga IFC, Nicolas Marquier, u shpreh se hapja e këtij ankandi përfaqëson jo vetëm përparimin në sektorin e energjisë, por edhe një hap të rëndësishëm drejt një të ardhme më të qëndrueshme të gjelbër për Kosovën dhe Evropën. Për realizimin e këtij projekti ministrja Rizvanolli ka falënderuar për bashkëpunim Korporatën Ndërkombëtare Financiare (IFC) të përkrahur nga qeveria gjermane si dhe ka shprehur mirënjohje të veçantë për Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID Kosovo) dhe Qeverinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për përkrahjen e madhe dhe të vazhdueshme për sektorin e energjisë dhe Kosovën.

Përdorim rekord i qymyrit në botë më 2024

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Përdorimi botëror i qymyrit pritet të arrijë nivel rekord të gjitha kohëve më 2024, ka thënë Agjencia Ndërkombëtare për Energji, teksa viti që po lëmë pas, sipas të gjitha gjasave, do të jetë më i ngrohti i regjistruar në histori.

Pavarësisht prej thirrjeve për ta ndalur djegjen e lëndës më të ndyrë fosile të njerëzimit që po nxit ndryshime klimatike, ANE ka thënë se pret që kërkesa globale për qymyr të arrijë shifra rekorde për të tretin vit rresht, raporton AFP.

Shkencëtarët kanë paralajmëruar se gazrat serrë që ngrohin planetin duhet të reduktohen në mënyrë drastike për ta kufizuar ngrohjen globale në mënyrë që të shmangen efektet katastrofike ndaj Tokës dhe njerëzimit. Më herët, në dhjetor, monitoruesi i klimës i Bashkimit Evropian, Copernicus, tha se viti 2024 "pothuajse sigurisht" do të jetë më i nxehti në histori - duke thyer rekordin e vënë nga viti i kaluar. Raporti "Thëngjilli 2024" i ANE-së, i publikuar të

mërkurën, parashikon se bota do ta arrijë kulmin e përdorimit të thëngjillit më 2027, teksa vetëm këtë vit ka kapërcyer shifrën e 8.77 miliardë tonëve.

Por, kjo do të varet nga Kina, e cila gjatë çerekshekullit të fundit ka konsumuar 30 për qind më shumë qymyr sesa pjesa tjetër e botës bashkë, ka thënë ANE.

Kërkesa në rritje e Kinës për energji ka qenë faktori më i madh prapa rritjes së përdorimit të qymyrit, teksa më shumë se një e treta e qymyrit të përdorur në botë është karbonizuar në



termocentralet e saj. Rritja e kërkesës për qymyr në Kinë, si dhe në ekonominë në rritje, si India dhe Indonezia, zvogëluan rënien e vazhdueshme në ekonominë e avancuar. Megjithatë, kjo

rënie është ngadalësuar në BE dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Përdorimi i qymyrit atje pritet të ulet për 12, përkatësisht 5 për qind, krahasuar me 23 dhe 17 për qind më 2023.

Monopatina shpërthyese. Si u eleminua gjenerali rus



Pas dëmit, edhe fyerja: jo vetëm që agjentët e fshehtë ukrainas vranë një gjeneral rus mu brenda në Moskë, por edhe e filmuan...

Një atentat i jashtëzakonshëm ka tronditur Moskën, duke përfshirë jo vetëm eliminimin e një gjenerali të lartë rus, por edhe një goditje të fortë ndaj sigurisë së qytetit. Në një operacion të guximshëm, agjentët ukrainas vranë gjeneralin 54-vjeçar Igor Kirillov, kreun e njësisë përgjegjëse për trajtimin e rrezatimit dhe armëve kimike e biologjike në ushtrinë ruse. Ngjarja ndodhi në lagjen Ryazansky Prospekt, ku shpërtheu një monopatinë elektrike e parkuar pranë një ndërtese.

Pamjet e sulmit, të regjistruara nga brenda një makine dhe që supozohet se janë realizuar nga shërbimi sekret ukrainas (SBU), tregojnë dy persona që afrohen te një derë përpara se monopatina të shpërthejë. Ky moment tronditës nuk ishte vetëm

një akt dhune, por një mesazh i qartë nga Ukraina, e cila e konsideroi këtë veprim një "hakmarrje legjitime" ndaj një kriminelit luftë.

Një zyrtar i lartë i SBU-së konfirmoi se Kirillov ishte shënjestër për shkak të përdorimit të armëve kimike të ndaluara ndërkombëtarisht, kundër forcave ukrainase. Sipas Kievit, Rusia ka përdorur armë kimike në të paktën 4,800 raste gjatë konfliktit, duke shkaktuar dëme të rënda për rreth 2,000 ushtarë ukrainas.

Shpërthimi dhe reagimet

Shpërthimi ndodhi në orën 6:12 të mëngjesit, duke shkaktuar dëme deri në katin e tretë të ndërtesës dhe në pallatin përballë. Autoritetet ruse raportuan se shpërthimi ishte shkaktuar nga një kilogram eksploziv. Ky operacion të kujton precizionin e sulmeve izraelite kundër shkencëtarëve iranianë që punojnë

për zhvillimin e armëve atomike. Nuk është rasti i parë kur shërbimet sekrete ukrainase kryejnë atentate në tokën ruse. Një nga rastet më të njohura ishte vrasja e Darya Duginas, vajzës së ideologut rus Aleksandër Dugin, në gusht 2022. Por ndryshe nga ai rast, ku mendohet se objektivi ishte vetë Dugin, eliminimi i Kirillovit ishte i menduar mirë dhe i ekzekutuar pa gabime.

Akuzat


Kirillov ishte një figurë qendrore në ushtrinë ruse dhe akuzohet për përdorimin e agjentëve kimikë si Chloropicrin, një substancë që shkakton inflamacion të rëndë në sistemin respirator dhe sytë. Ai ishte sanksionuar më parë nga Mbretëria e Bashkuar për këto praktika. Megjithatë, Rusia e kishte mohuar përdorimin e armëve kimike dhe kishte akuzuar Ukrainën dhe SHBA-

në për krijimin e laboratorëve biologjikë, pretendime që nuk janë vërtetuar kurrë.

Reagimet ndërkombëtare

Moska ka reaguar ashpër, duke kërcënuar me hakmarrje. Ish-presidenti Dmitri Medvedev dhe figura të tjera të larta ruse kërkuar ndëshkimin e autorëve të sulmit. Nga ana tjetër, SHBA-të kanë marrë distancë, duke deklaruar përmes një zyrtari të lartë se "nuk mbështesin" aksionin dhe se Ukraina nuk i kishte informuar paraprakisht.

Ky atentat shënon një kthesë të re në tensionet midis Ukrainës dhe Rusisë, duke e sjellë konfliktin në një dimension më personal dhe duke thelluar ndarjet gjeopolitike. Ndërsa Moska betohet për hakmarrje, mbetet për t'u parë se si do të ndikojë ky zhvillim në ecurinë e luftës. / bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Ramadani: Tani të mendojmë për sfidën me Francën

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futsall shënoi fitore në ndeshjen e dytë të kualifikimeve për "Euro 2026" në fazën "Main Round" ndaj Gjeorgjisë (3-1). Pas ndeshjes, përzgjedhësi i Kosovës, Agon Ramadani, ka thënë se lojtarët treguan angazhim të madh në fushë, por se tani duhet qëndruar më këmbë në tokë. "Ne jemi përgatitur që ta bëjmë maksimumin në këtë ndeshje

sepse nuk donim të lejonim befasi. Jam shumë i kënaqur me angazhimin e lojtarëve. Angazhimi i tillë nuk ka munguar as në Gjeorgji, por atje nuk shkoi gjithçka qysh e kishim parashikuar. Normalisht se gëzimi i fitores para tifozëve tanë është shumë i madh", ka thënë Ramadani. "Lojtarët patën dëshirë të flaktë për fitore dhe e realizuan atë. Ne treguam se më nuk jemi autsajder. Dihet se në grup e kemi Francën që ishte në

vend të tretë dhe Gjeorgjinë që ka qenë në çerekfinale në Evropianin e kaluar, por ne do të vazhdojmë të punojmë me përkushtim për ta ndjekur objektivin për dy vendet e para në grup. Natyrisht se nuk është e lehtë. Duhet të qëndrojmë me këmbë në tokë dhe të luftojmë deri në fund. Na pret një pushim prej një muaji dhe duhet ta mbajmë formën që të paraqitemi denjësisht kundër Francës", ka deklaruar Ramadani.



Rrahmani shpallet lojtari i huaj më i mirë në Rumani

Bukuresht, 18 dhjetor - Sulmuesi nga Kosova, Albion Rrahmani, është shpallur lojtari më i mirë i huaj në Rumani. Rrahmani këtë çmim e mori nga Shoqata e Futbollistëve Amatorë dhe Joamatorë të Rumanisë në një ceremoni që u mbajt mbrëmjen e së hënës. Pas marrjes së këtij çmimi reagoi edhe vetë lojtari, i cili ka bërë me dije se ndihet i lumtur dhe i nderuar që është bërë fitues i tij. "Jam shumë i lumtur dhe shumë i nderuar që jam votuar nga trajnerët dhe lojtarët si lojtari më i mirë i huaj i sezonit 2023/2024 organizuar nga AFAN. Një falënderim i veçantë për ish-shokët e mi të skuadrës, stafin e trajnerëve dhe të gjithë atyre që më ndihmuan të kem një sezon të mrekullueshëm. Zoti na bekoftë të gjithëve!", ka shkruar



Rrahmani, i cili shkëlqeu me fanellën e Rapid Bukureshtit klub tek i cili ishte transferuar te Ballkani. Pas paraqitjeve

fantastike në elitën e futbollit rumun, ai u shit për pesë milionë euro te Sparta Praga, që ishte shifër rekord për klubin çek.

SHKURT

UEFA e cakton Visar Kastratin gjyqtar kryesor në ndeshjen e Ligës së Konferencës

UEFA e ka deleguar Visar Kastratin gjyqtar kryesor për ta ndarë drejtësinë në ndeshjen Molde - Mlada Boleslav në kuadër të garës Ligës së Konferencës - faza e grupeve. I deleguar nga UEFA është edhe gjyqtarët Dardan Çaka si AVAR. Në ndeshjen që do të zhvillohet në stadiumin "Molde Stadion" në Norvegji, Kastratin do ta asistojnë Fatmir Sekiraqa dhe Arbnor Bullatovci, ndërsa gjyqtari i katërt do të jetë Lirim Jashari. Kjo ndeshje do të zhvillohet të enjten, më 19 dhjetor, me fillim në orën 21:00.

Sonte shpallen më të mirët e vitit në basketboll

Sonte (e enjte) nga ora 19:00 do të mbahet Gala Mbrëmja "Laureatët 2024". Në këtë mbrëmje festive, që organizohet nga Federata e Basketbollit e Kosovës, do të nderohen më të mirët e këtij viti. Në "Laureatët 2024" do të shpallen Basketbollisti më i miri i vitit 2024, Basketbollistja më e mirë e vitit 2024, top 5 te meshkujt dhe femrat. Po ashtu, do të shpallen klubet më të mira te meshkujt dhe femrat, Trajneri i Vitit, Gjyqtari i Vitit, Punëtori Sportiv i Vitit, Shpresa e Vitit te djemtë dhe vajzat, kontribuues i basketbollit, veteran dhe veterane etj. Në vitin e kaluar çmimi i më të mirit i takoi Drilon Hajrizit, derisa më e mira ishte shpallur Arbnore Përçuku.

KB Vëllaznimi ndan rrugët me Rushitin e Ejupin

Basketbollistët Arbin Rushiti e Visar Ejupi nuk janë më pjesë e skuadrës së Vëllaznimit që bën gara në Superligën e Kosovës. Klubi nga Gjakova ka njoftuar të martën se ka mbyllur bashkëpunimin me dy basketbollistët, të cilët i ka falënderuar për kontributin dhe u ka dëshiruar suksese në vazhdim të karrierës. "Me marrëveshje të dyanshme kemi mbyllur bashkëpunimin me lojtarin nga Shkupi - Arbin Rushiti, të cilin e falënderojmë për kontributin dhe i dëshirojmë suksese në vazhdim të karrierës. Një tjetër falënderim për kontributin e dhënë ndajmë për Visar Ejupin, i cili ishte pjesë e jona gjatë kësaj periudhe vjeshtore. I dëshirojmë suksese në vazhdim", thuhet në njoftimin e Vëllaznimit. Aktualisht, Vëllaznimi është në pozitën e gjashtë në tabelë me 5 fitore e 7 humbje pas 12-të xhirove të luajtura deri më tani.

Juventus dhe Roma shprehin interesim për Zhegrovën

Dy klubet italiane, Juventus dhe Roma, kanë shfaqur interesim për ta transferuar sulmuesin e Përfaqësueses së Kosovës që aktivizohet te Lille, Edon Zhegrovën. Sipas raportimeve të medieve

italiane, klubi torinez dhe kryeqytetasit pritet ta vazhdojnë punën për ta tentuar afrimin e Zhegrovës këtë merkato. Megjithatë, duket se "bardhezinjtë" janë disi më të avantazhuar në këtë garë, për shkak se

"Zonja e Vjetër" ka marrëdhënie të shkëlqyera me agjentin e sulmuesit, Hasn Cetinkaya, duke qenë se është i njëjti person që shiti Denis Zakaria për 20 milionë te Monaco. Tashmë mbetet për t'u parë se cila

do të jetë zgjedhja e Zhegrovës në fund, mirëpo ajo që dihet është 25-vjeçari është kthyer ndër lojtarët më të kërkuar të çastit, teksa këtë sezon ka arritur të shënojë plot tetë gola e të asistojë dy të tjerë.



Milwaukee fitoi Kupën në NBA

MILWAUKEE, 18 DHJETOR - Basketbollistët e Milwaukee Bucksit fituan Kupën e NBA-s duke mundur në finale Oklahoma City Thunderin me rezultat 97:81. Milwaukee e kishte më të lehtë të merrte fitore pas një paraqitje të jashtëzakonshme nga

Giannis Antetokounmpo, i cili regjistroi një performancë triple-double dhe u bë MVP i Kupës NBA. Ylli grek shënoi 26 pikë me 19 kërcime dhe 10 asistime në finale derisa Damian Lillard shtoi 23 pikë të tjera. Nga ana tjetër, Shai

Gilgeous-Alexander shënoi 21 pikë për OKC, por që nuk mjaftuan për të marrë fitore. Në këtë mënyrë Milwaukee pasoi Los Angeles Lakersi si fitues i Kupës NBA dhe çdo lojtar i Bucksit mori gjysmë milioni dollarë si çmim. Për disa lojtarë, kjo shifër do të

thotë vërtet shumë. Gjegjesisht Stanley Umude, Liam Robbins dhe Ryan Rollins kanë një pagë vjetore prej më pak se 600 mijë dollarë dhe në këtë mënyrë ata do ta përmirësojnë ndjeshëm llogarinë e tyre bankare.



Vinicius: U munduan të më diskreditonin, por jam më i miri në botë

MADRID, 18 DHJETOR - Vinicius Junior ka marrë hak. Pas dëshpërimit që nuk ia dhanë "Topin e Artë", ylli brazilian u zgjodh futbollisti më i mirë në botë për vitin 2024 nga FIFA. Një kurorëzim dhe mirënjohje për atë që e bëri 24 vjeçari gjatë vitit që po e lëmë pas duke e fituar Ligën e Kampionëve dhe La Ligan me Real Madridin. Një triumf të cilin Viniciusi ka dashur ta festonte kështu në rrjetet sociale: "VENI, VIDI, VICI. Sot shkruan ai djaloshi që ka parë shumë idhuj duke e ngritur lart këtë trofe... dhe tash është i tij. Ose më mirë të them, ka arritur çasti im. Është momenti ta them... po, jam lojtar i mirë në botë dhe kam luftuar shumë për këtë", ka shkruar fillimisht në "Instagram", ylli brazilian i "Los Blancos". "Provuan dhe u munduan të më



diskreditonin, të më nënçmojnë. Askush nuk mund të më tregojë se për kë duhet të luftoj, se si duhet të sillem. Kur isha në 'Sao Gonçalo', sistemi nuk brengosej për mua dhe unë pothuajse u gëlltita prej tij. Kam fituar për mua, për familjen time, duke gjetur aq shumë mbështetje në

këtë rrugëtim të gjatë: Flamengo, Real Madridi, kombëtarja braziliane, qindra bashkëlojtarë të skuadrës në rrugëtimin disavjeçar... personat që më shoqërojnë çdo ditë, njerëzit që më admirojnë. Jam më i miri i botës", ka shtuar Vinicius Junior.

Nadali: Dhimbja është një nga mësuesit më të mëdhenj të jetës

MAJORKA, 18 DHJETOR - Një karrierë e ndërtuar mbi sakrificë, punë të palodhur dhe dhimbje, përveç talentit të tij të jashtëzakonshëm. Rafa Nadal ka rrëfyer anën e panjohur të karrierës së tij përmes një letre të publikuar në "The Players Tribune". "Dhimbja është një nga mësuesit më të mëdhenj të jetës", shkruan ish-tenisti nga Majorka. "U lëndova kur isha 17 vjeç dhe më thanë se ndoshta nuk do të mund të isha më kurrë tenist profesionist. Në atë moment mësova se gjërat mund të marrin fund në një çast. Nuk ishte vetëm një thyerje e vogël



në këmbë, ishte një sëmundje. Një sëmundje pa kurë, që vetëm mund të menaxhohej". Nadal bën zbulimin befasues: "Unë kisha sindromën 'Mueller-Weiss'. Kalova nga gëzimi më i madh të zgjimi të nesërmen, i paaftë

për të ecur. Kam kaluar shumë ditë në shtëpi duke qarë dhe ishte mjaft poshtëruese. Kam pasur fatin të kem një baba që ka ndikuar pozitivisht në çdo çast të jetës sime, një person të veçantë, që gjithmonë ka qenë shumë optimist. 'Do të gjejmë një zgjidhje, dhe nëse nuk do ta gjejmë, ka gjera të tjera në jetë përveç tenisit'. Kur i dëgjova ato fjalë, mezi arrita t'i përpuñoja, por falë Zotit, pas shumë dhimbjesh, ndërhyrjesh kirurgjikale, rehabilitimi dhe lotësh, u gjet një zgjidhje dhe gjatë gjithë këtyre viteve munda të vazhdoj të luftoj".

SHKURT

Muriqi suspendohet me një ndeshje, mungon ndaj Getafes

Sulmuesi i Kosovës, Vedat Muriqi, do t'i mungojë skuadrës së Mallorcas për duelin e radhës në kampionat. Ai nuk do të jetë në dispozicion të trajnerit për ndeshjen ndaj Getafes, që Mallorca e luan të shtunën në udhëtim në kuadër të xhiros së 19 në La Liga. Muriqi është suspenduar me një ndeshje moslojë nga komisioni disiplinor për shkak të ndëshkimit me karton të kuq vikendin e shkuar ndaj Gironas. Mallorca e fitoi ndeshjen 2-1, ndërsa Muriqi u ndëshkua me karton të kuq për ndërhyrje të rrezikshme, duke bërë që të pezullohet me një ndeshje moslojë. Për Muriqin kjo është hera e dytë që merr një suspendim të tillë këtë sezon pasi i mungoi Mallorcas edhe kundër Valencias për shkak të ndëshkimit me karton të kuq ndaj Las Palmasit. Në 14 ndeshje të luajtura këtë sezon në kampionat, 30-vjeçari Muriqi ka shënuar tri gola dhe ka bërë një asistim.

Benzema mendon rikthimin te Reali, por jo si futbollist

Real Madridi mund ta rikthejë Karim Benzeman, sulmuesin e Al-Itihadit. Marca thotë se ish-ylli i Realit po shqyrton të ardhmen e tij dhe mund t'i varë këpucët në fund të sezonit të Ligës Pro Saudite. Kontrata e Benzemas zgjat deri në vitin 2026, por ai është i përgatitur të heqë dorë nga 100 milionë euro në vitin e fundit të marrëveshjes së tij. Dhe nëse ai vendos të tërhiqet nga futbolli i luajtur, Benzema mund të kthehet te Real Madridi në cilësinë e ambasadorit të klubit. Sipas Relevo, sulmuesi francez, ka mbajtur marrëdhënie të shkëlqyera me presidentin Florentino Perez dhe po zhvillohen bisedime që ai të bëhet ambasador i klubit për botën arabe.

Matthaus: Këta janë futbollistët që mund të largohen nga Bayerni

Lothar Matthaus, ikona e Bayern Munichut, foli për largimet e mundshme nga bavarezët. Njëri prej lojtarëve që pritet të largohet sipas ish-futbollistit janë Coman, Gnabry dhe Sane. "Sigurisht se do të ketë ndryshime në pozicionin e sulmuesit të krahut. Tre janë kandidatët: Coman, Gnabry dhe Sane. Të tre nuk do të qëndrojnë te Bayerni vitin e ardhshëm, edhe pse me siguri nuk do të përmend emra tani. Sigurisht që nuk do të qëndrojnë të tre, të paktën një do të largohet, ndoshta edhe dy, sepse edhe për këto pozicione në Mynih vlerësohen emra të rinj", ka thënë Matthaus. "Sane: Unë ende e shoh aftësinë e tij. Kur ai të jetë në formë, ai do ta ketë ritmin e tij dhe do të fitojë besim përmes stërvitjes në ndeshje, por ai është ende shumë larg nga forma e tij më e mirë", ka shtuar Matthausi.

McTominay: E vështirë të largohesha nga 'Old Trafford', por s'e kthej kokën pas

Scott McTominay, mesfushor i Napolit, ka dhënë një intervistë për edicionin skocez të BBC-s. Ai ka folur për vendimin për të lënë Manchester Unitedin dhe për t'u transferuar te Napoli për të luajtur në Serinë A: "Ishte një vendim i rëndësishëm, por në një farë mënyre edhe mjaft i thjeshtë.

Pashë tifozë pasionantë, trajnerin dhe lojtarët, ishte një mundësi dhe e shfrytëzoja. Nuk shikoj pas. E dija që ishte ajo që doja dhe nuk kam asnjë pendesë. Kur e vendos diçka, ashtu do të jetë. Asgjë nuk mund të më kthejë prapa". "E dua këtë vend, i dua tifozët dhe shokët e mi të skuadrës. Ka

qenë një kënaqësi të ndaja këtë përvojë me Billy Gilmour çdo ditë, ndihmuam shumë njëri-tjetrin. Largimi nga 'Old Trafford' ishte një vendim imi, i klubit dhe i trajnerit. Nuk është e lehtë për një klub të marrë një vendim të tillë për një lojtar që është rritur në akademi", ka shtuar ai.

Në fund, McTominay ka shtuar: "Dita ime e fundit në Manchester ishte e vështirë, sidomos kur m'u desh t'i përshëndesja të gjithë. Por futbolli dhe jeta janë kështu... Pashë më pas me Ten Hag dhe ai shprehu mendimet e tij për situatën. I thashë të më dëgjonte, se ishte karriera ime

dhe se isha atje për ta çuar përpara. Duhej ta ndiqja instinktin tim dhe të bëja atë që doja për karrierën time, pa lejuar që faktorët e jashtëm të më ndalonin. E dua Manchester Unitedin pa masë. Ka qenë jeta ime për 22 vjet, por tani shoh përpara dhe te Napoli po e kaloj shumë mirë".



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë-Ministraskvo Pravde-Ministry of Justice



Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar / Agjencia za Upravljanje Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom/ Agency for Administration of Sequestered and Confiscated Assets

FTESË PËR OFERTIM PËR DHËNJE ME QIRA TE LOKALEVE

Datë 18.12.2024

Referenca: AAPSK- 016/2024

AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për dhënie me qira të Lokaleve ne Prizren, sipas përshkrimit të më poshtë:

Nr	Përshkrimi	Çmimi Fillestar	Çmimi nga ofertuesi
1	Lokal 174 m ² , kati përdhes, nr. Rruga "Tirana" Prizren Lokali është i ndërtuar ne pjesën e objektit "Albanika", ne Prizren, dhe posedon: Pjesa e hyrjes se lokalit dhe Banjon	Total: 2,660.00€ për muaj	
2	Lokal 92m2, kati përdhes, nr. Rruga "Tirana" Prizren Lokali është i ndërtuar ne pjesën e objektit "Albanika", ne Prizren, dhe posedon: Pjesa e hyrjes se lokalit dhe Banjon		

Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e mbyllur në zarf duhet të dorëzohet më së largu deri më: 26.12.2024 në ora 10:00h, në lokalet e AAPSK-së, Divizioni i Shitjes (në adresën e poshtëshënuar). Të interesuarit objektet mund ti shikojnë me datë: 23.12.2024, prej orës 11:00-12:00 në adresën e lartë shënuar.

Pasurit e sekuestruar ose te konfiskuara në këtë procedure te ofertimit procedohen me Qira, me çmimin e lartë cekur në gjendjen siç janë.

Vërejtje: Lokalet gjenden ne dy njësi kadastrale por meqenëse gjendja faktike është se janë te bashkuara ne një, atëherë lokalet lëshohen me qira ne tersi te m² dhe çmimit total për qira mujore.

Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me veti të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Lokalet do ti jepen në shfrytëzim me qira ofertuesit që ofron çmimin më të lartë për muaj.

Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit-listën e artikujve në zyrën nr. 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e AAPSK-se në: <https://aapks.rks-gov.net> apo <https://md.rks-gov.net/>.

Në zarf të shkrutet për: AAPSK, Divizioni i Shitjes; oferta mos të hapet para orës 10:00. Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, kati 10, Divizioni i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 67 254.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Fadil Thaqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "Haxhi Hoti.

- Agim Pjetri nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollë së mesme "Nexhmedin Nixha".

- Aldena Fazlji shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Gardjan Zeneli shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Fadil Hisari " Prizren.

- Lindihana Jusufi shpall të pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi " Prizren.

- Islam Hasanaj nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit " Compania Hasanaj" sh.p.k. me numër Identifikues: 810247206.

- Endrit Dhomi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



ROYAL CROWN
RC
cola

**ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS**

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1908

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1908
0.5L



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

